



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

**RELACION TEKNIK**

(KONTRATA NR.2)

Mirembajtje me performance rruga: "**Koplik- Bogë, Bogë-Theth, Dedaj-Razëm**"

*Përshkrim i përgjithshëm.*

Akset rrugore " **Koplik- Bogë**" dhe "**Dedaj – Razëm**" qe kane qene pjese e inventarit te DRV Shkoder. Segmenti rrugor "**Bogë-Theth**" eshte segment rrugor qe i eshte shtuar inventarit te Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër me anë të VKM-së Nr.600 datë 13.10.2021. Këto segmente janë rrugë lidhëse të qytetit të Shkodrës me pikat turistike te Razmes, Boges dhe Thethit . Segmentet klasifikohen te kategorisë F si rrugë lokale, me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (pa vijë në mes), me dy bankina 50 cm të paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese e segmenteve ne fjale është 4-4.5 ml. Për nga shtrirja gjeografike segmentet rrugore "**Koplik- Bogë**" dhe "**Dedaj – Razëm**" kalojne nëpër një terren malor dhe klasifikohet me mirëmbajtje dimërore. Segmenti "**Bogë-Theth**" nëpërmjet vendimit të Bordit Drejtues të ARRSH-së Nr. 2 datë 15.02.2022 është cilësuar ne segment me mirëmbajtje dimërore që kalon nëpër një terren malor me shkallë vështirësie të lartë. Ne tabelen e mëposhtme jane paraqitur segmentet qe perbejne kete kontrate.

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Koplik- Bogë	28.9	42°13'12.5"	19°26'44.5"	42°23'50.0"	19°38'40.9"
2	Bogë-Theth	26.8	42°23'50.0"	19°38'40.9"	42°23'44.3"	19°46'24.4"
3	Dedaj-Razëm	11.6	42°17'24.0"	19°31'51.0"	42°20'41.6"	19°33'02.3"
Shuma (km):		67.3				

*Kushtet e inspektimit.*

Sot me datë 26.03.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore "**Koplik- Bogë, Bogë-Theth, Dedaj-**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

**Razëm**". Bazuar në urdhërin e brendshëm për përlllogaritjen e fondit limit, si objektiv i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029) , me qëllim hartimin e preventivave për përlllogaritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

***Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .***

Gjëndja e akseve rrugore " **Koplik- Bogë**" dhe "**Dedaj – Razëm**" është mesatare në përgjithësi me disa problematika që vijnë edhe si pasojë degradimit të disa elemnteve rrugorë që favorizohen nga relievi i vështirë malor dhe nga kushtet ekstreme atmosferike. Ndersa segmenti rrugor "**Bogë-Theth**" sidomos pjesa "**Q.Thore –Theth**" eshte segment i saporikonstruktuar por qe ka disa problematika te rreshqitjeve. Ruga ka disa shëmbje të mureve mbajtës e pritës dhe disa çedime në trupin e saj. Edhe shtresat asfaltike kanë filluar pjesërisht të amortizohen, ku me amortizim edhe gjatë 4- 5 viteve të ardhshme do të linde nevoja për realizimin e riveshjeve pjesore. Duhet menjëhere pas lidhjes së kontratës së mirëmbajtjes të kryhen disa punime rehabilitimi në mënyrë që rruga të sillet në një standart të pranueshëm për qarkullimin e mjeteve, dhe gjatë zbatimit të kontratës së ardhshme të realizohen punime rehabilituse periodike për ta mbajtur në kushte të duhura teknike për qarkullimin e mjeteve.

***Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.***

● Segmenti rrugor "**Koplik- Bogë**" është një segment me gjatësi 28.9 km. Gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit kryesisht ne segmentin Dedaj - Boge, që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja te dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve bashkangjitur këtij relacioni që janë plotësuar në terren dhe janë ndarë në segmente rrugorë prej 1km. . Këto çarje apo rrjepzime të asfaltit vijnë si pasojë e ndikimit të kushteve të vështira atmosferike, si dhe nga ujërat nëntokësorë dhe bazamentit të paqëndrueshëm të rrugës dhe gjerësisë se vogel te pjeses kaluese te rruges qe sjell si pasoje dhe demtimine buzeve te asfaltit dhe bankinave. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar ndërtimi i kunetave me bordurë, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela. Po kështu është menduar që për të gjitha pjesët e riveshura të realizohet dhe vijëzimi i saj sipas standartit aktual që ka rruga. Megjithëse rruga është pajisur pjesërisht me sinjlistikë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

vertikale, përseri kemi evidentuar disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4 ose 5 viteve të ardhshme. Është menduar dhe një shtim të sasisë së guardrailave pasi ka zona ku është e domosdoshme vendosja e tyre. Vendodhja e tyre është përcaktuar në tabelën e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit. Në kilometrin 11.9 është menduar ndërtimi i nje muri guri me gjatësi 50 ml dhe volum prej 150m<sup>3</sup> në krahun e djathtë. Në kilometrin 15.3 është menduar ndërtimi i nje tjetër muri guri me gjatësi 100 ml dhe volum prej 300m<sup>3</sup> në krahun e djathtë. Në kilometrin 21.2 është menduar ndërtimi i nje parapeti prej betoni me gjatësi rreth 50 ml dhe lartësi mesatare 1ml në krahun e djathtë. Në kilometrin 16.9 është menduar ndërtimi i një muri gabioni në një sasi prej 90 m<sup>3</sup>. Në kilometrin 25.3 është menduar ndërtimi i nje parapeti prej betoni me gjatësi rreth 300 ml dhe lartësi mesatare 1ml në krahun e djathtë, dhe I nje muri guri me volum prej 15 m<sup>3</sup>. Volumet e punimeve te tjera jane paraqitur te fragmentarizuara ne segmente prej 1km ne tabelat e shperndarjes se punimeve.

• Segmenti rrugor **“Bogë-Theth”** është një segment me gjatësi 26.8 km. Gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit kryesisht gjatë pjesës së parë të tij Bogë-Qafe Thore, që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Këto çarje apo çedime të asfaltit vijnë si pasojë edhe të demtimit nga mjetet e rëndë atë ushtrisë që kanë hapur atë aks rrugor para se të kalojë në inventarin e ARRSH-së. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar ndërtimi i kuletave me bordurë, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabelat. Megjithatë rruga është pajisur pjesërisht me sinjlistikë vertikale, përseri kemi evidentuar disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4-5 viteve të ardhshme. Është menduar dhe një shtim të sasisë së guardrailave pasi ka zona ku është e domosdoshme vendosja e tyre, pasi edhe guarderelat ekzistuese janë të demtuara (Sidomos në zonën e Qafe Thores ku kemi dhe prani të orteqeve. Vendodhja e tyre është përcaktuar në tabelën e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit. **Ne pjesën e tuneleve në zonën e Qafe Thores theksojmë se duhet që të bashkohen tunelet ekzistues dhe të zgjaten në mënyrë që të kemi një tunel të vazhduar panoramik me një gjatësi prej të paktën 500-600 ml në mënyrë që të shmangen aksidentet e mundshme nga rënia e orteqeve dhe hapja e rrugës në këto raste të bëhet në një kohë me të shkurter. Për këto punime i është bërë kërkesë dhe ARRSH-së për të shqyrtuar mundësinë e një investimi pasi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

**vlerrat e këtyre punimeve nuk mund të perballohet nga kategoria e punimeve rehabilituese periodike e kontratës së mirembajtjes.**

Në kilometrin 15 për të shmangur keputjen e aksit rrugor në 3 pika është menduar ndërtimi i tre mureve i pari prej butobetoni dhe dy të tjeret prej gabioni. Në këtë pjesë është menduar dhe riparimi i të gjithë shtresave të asfaltit. Të gjithë pjesët që do riveshen janë llogaritur të behen edhe vijezimet.

Gjatë gjithë gjatësisë së segmenteve janë parashikuar dhe riparime të tjera të vogla të mureve mbajtjes dhe pritës apo brezave të betonit, punime të cilat evidentohen në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit.

- Segmenti rrugor **“Dedaj – Razëm”** është një segment me gjatësi 11.6 km. Gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar ndërtimi i kuletave me bordurë, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela. Megjithatë rruga është pajisur pjesërisht me sinjlistikë vertikale, përseri kemi evidentuar disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4-5 viteve të ardhshme. Është menduar dhe një shtim të sasisë së guardrailave pasi ka zona ku është e domosdoshme vendosja e tyre, pasi edhe guarderelat ekzistuese janë të demtuara. Vendodhja e tyre është përcaktuar në tabelën e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit.

***Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.***

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasi të këtyre punimeve të paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet më të lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave të rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilituese periodike.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

**Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :**

Nr.Ana	Përshkrimi I punimit	Njesia
	<b>1. PUNIME GERMIMI</b>	
3.119/a	Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m <sup>3</sup> , shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne toke,	m3
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3
3.161/2	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.25m3	m2
	<b>2. PUNIME SHITESASH</b>	
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2
3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3
	<b>3. ANALIZA TEKNIKE</b>	
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.226/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2
	<b>4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE</b>	
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3
	<b>5. PUNIME HEKUR BETONI 3</b>	
3. 287	F V hekur betoni i zakonshem $\varnothing$ 6 ~ 10mm	ton
3. 288	F V hekur betoni i zakonshem $\varnothing$ > 12mm	ton
	<b>6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME</b>	
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3
	<b>7. PUNIME TE NDRYSHME</b>	
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml
	<b>8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE</b>	
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë
	<b>11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>	
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë
3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë
3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml

***Foto nga inspektimi në terren.***

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Më poshtë fotot e realizuara në terren :





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR







REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





---

**REPUBLIKA E SHQIPËRIË**  
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**  
**DREJTORIA E RAJONIT VERIOR**



**GRUPI I PUNËS :**

